

KONTRATË SHITBLERJE

(KUOTASH)

Sot më datë 10/06/2021 palët e mëposhtme kontraktuese lidhin këtë Kontratë Shitblerje Kuotash:

Shitësi: **Znj. Saida Komi**, e bija e Durim, shtetase shqiptare, lindur më 03.05.1998, në Shkodër dhe banuese në adresën: Rr. Studenti, lagjia nr.1, ndertesa 028, Shkoder, 4001, identifikuar nga Letërnjoftimi me Nr. Personal J85503041B;

(referuar me poshtë si **Shitësi**)

Blerësi: **Z. Theodhori Kokëdhima**, shtetas shqiptar, lindur më 02.10.1996 në Vlorë dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr. "Sitki Çiço", Pallati 2K, Ap. 18, Tiranë, identifikuar me Letërnjoftim ID Nr. J61002060A, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar. (referuar me poshtë si **Blerësi**)

Dispozita të përgjithshme

- A. Shoqëria "Medifeel Albania" sh.p.k, është person juridik, i regjistruar në Regjistrin Tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me Nr. NUIS M11426503E. Kapitali i shoqërisë "Medifeel Albania" SHPK është 1.000 (një mijë) Lekë.
- B. Shitësi është ortak i vetëm i Shoqërisë "Medifeel Albania" sh.p.k dhe zotëron një kuotë në Kapitalin e Shoqërisë me pjesmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind).
- C. Në përputhje me nenin 73: "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave" pika 1/b dhe pika 3 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare», neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si dhe në Statutin të Shoqërisë "Medifeel Albania" sh.p.k, Palët bien dakord sa më poshtë:

Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja e 50 % të kuotës që Shitësi zotëron në kapitalin themeltar, e cila përfaqëson 50 % (pesëdhjetë përqind) të Kapitalit të Shoqërisë. Kjo kuotë transferohet nga Shitësi në pronësi të Blerësit.
- 1.2 Blerësi pranon pronësinë e 1 (një) kuote dhe pranon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pronësi.

Neni 2 Çmimi i Shitjes



- 2.1 Çmimi për blerjen e kuotës do të jetë kundrejt vlerës së saj nominale, në total i barabartë me 500 (pesëqind) Lekë. Kjo shumë është likuiduar totalisht në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 3 Garancitë

- 3.1 Shitësi është pronari i vetëm i ligjshëm i 1 (një) kuote në shoqërinë “Medifeel Albania” sh.p.k.
- 3.2 Shitësi garanton Blerësin që kuota e transferuar është krejtësisht e lirë dhe nuk është vendosur si mjet ligjor për të siguruar ekzekutimin e ndonjë detyrimi.

Neni 4 Regjistrimi

- 4.1 Regjistrimi i transferimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) është kryer në bazë të nenit 74 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » si dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 5 Ligji i zbatueshëm


- 5.1. Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe Statuti i Shoqërisë “Medifeel Albania” sh.p.k.

Neni 6 Juridiksioni

- 6.1. Për çdo mosmarrëveshje lindur mes Palëve lidhur me interpretimin, zbatimin e kontratës e cila nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre, juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Neni 7 Dispozita të fundit


- 7.1 Nenet e Përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.
- 7.2 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët.
- 7.3 Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e të dyja palëve, duke respektuar formën shkresore.



Kjo kontrate u përpilua në 3 kopje me vlerë të barabartë ligjore, në gjuhën shqipe dhe atë italiane. Palët deklarojnë se njohin dhe kuptojnë të gjithë përmbajtjen e kësaj kontrate, si në gjuhën shqipe dhe në atë angleze. Kontrata u pranua nga palët dhe u gjend sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të shprehur. Ajo u nënshkrua në mënyrë të rregullt nga palët.

SHITËSI

Znj. Saida Komi

Saida Komi


BLERËSI

Z. Theodhori Kokëdhima

Theodhori Kokëdhima
